



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot

Durrës, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Vegla Pastrimi”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30124120-1;
34132000-1; 39224300-1; 39224100-9; 4212243-3; 42122460-2; 4451100-5; 44511120-2

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 83431-04-27-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.166.000 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa Tvsh.

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Komunale Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdëklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kerkesat per kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa ne piken 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa ne piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me

sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e LPP, ne nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontraten.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontraten.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj.

Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë.

Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1(një) automjet per transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi, me qira ose ne huapërdorje.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/huapërdorim

Shenim 3.1: Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit, huadhenesit dhe huapërdoresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperme pranë AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

Ky kriter quhet i permbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe ne baze të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. ...”.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës.

Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, konkretisht me nevojën për transportin dhe shpërndarjen e materialeve të pastrimit në adresat e autoriteteve kontraktore, duke garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të shërbimit. Në këtë mënyrë, përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) në fazën e ofertimit lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët ekonomikë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese në fazën e vlerësimit përfundimtar siguron verifikimin e plotë të kapaciteteve të deklaruara, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, në përputhje me nenin 26, pika 1 dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake vetëdeklarimin e operatorit ekonomik në vend të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike apo palë të treta. Pra, operatorët ekonomikë, në momentin e paraqitjes së ofertës, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), duke deklaruar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, përfshirë edhe disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari paraqitjen e dokumenteve provuese që vërtetojnë saktësinë e vetëdeklarimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës, të dorëzuar në rrugë elektronike.

4. OE duhet të paraqesë në SPE Autorizim prodhuesi ose Distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuarat. Në rastet e autorizimit nga distributori, duhet të vërtetohet lidhja që distributori ka me prodhuesin. Në autorizim duhet të jete i paraqitur Nr i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Distributorit, Çertifikate cilesie produkti, në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet e nevojshme (për zerin nr. 28 dhe zerin nr. 31 në listë).

Argumentim: Ky është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në këtë procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njekohësisht me trregues të cilësive të mallrave që kërkohen

te blihen dhe qe jane prodhuar ne standartet apo prodhues te zyrtarizuar. Ky kriter eshte jodiskriminues, eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejt me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese sherben per njohjen e mundesise se Oeper permbushjen me sukses te kontrates. Në bazë të pikës 1 germa a dhe c, të nenit të 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”e ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

4. Operatori Ekonomik duhet te paraqese ne SPE Deklarate ne te cilen te mare persiper permbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar per çdo produkt sipas kerkesave te AK si dhe realizimin e kontrates sipas afatit 20 ditor.

Argumentim: Ne baze te nenit 36 te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kerkesave dhe specifikimeve.

5. Ofertuesit duhet te paraqesin:

Çertifikate Personale ISO 9001:2015 ose ekuivalente, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çerfikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime

ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001: 2015 (e velfshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit. Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.


ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

7. Operatori ekonomik ofertues, në ditën e hapjes së ofertave (përpara hapjes së tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, pranë NSHK Durrës, duhet të paraqesë të protokolluara një mostër për zerrat e kërkuar si më poshtë:

Zeri nr.2 - Kacia metalike. Gjeresi 30 cm * Gjatesi 30 cm me bisht druri ose metalike 70 cm



Zeri nr.3 - Lopata transporti = Te jene metalike me a=26cm b=34cm, me bisht druri 122cm



Zeri nr.5 - Lopata grryerje me bisht druri. Gjersi 24cm *Gjatesi 29 cm + mbajtesja e bishtit 10 cm,me bisht druri 122 cm



Zeri nr.6 - Furçe pastrami me fije metalike me bisht druri.Gjatesi 50 cm*Gjersi 6.5
*Trashesi 2,fije metalike 4 cm, me bisht druri 122cm i inkastruar me perforcime



Zeri nr.11- Shpatull metalike me bisht druri.Gjersi 9.5 cm*Gjatesi 15.5 cm ,me bisht druri 122cm



Zeri nr.22 - Steke lavazhi me presion 220-250 Bar = Te jete e kompletuar me doreze,steke,koke, pjeset te jene te çmontueshme dhe te pershtateshme me zerat nr 23, cilesore sipas standarteve CE.



Zeri nr.23 - Zorre per steke lavazhi = Te jete zorre qe te mbaj presion 220-250 bar e kompletuar me kokat rapide e pershtateshme me zerin 22,,21,24,29. Cilesore sipas standarteve CE



Zeri nr.24 - Reduktor per kapje te shpejte nga pompa tek zorra e lavazhit=Te jene material inox,e pershtateshme me zerin nr 21,23,29



Zeri nr.25- Koka per filispanje te motokorreseve STIHL (ose ekuivalent) te jene te paketuara standarte CE



Zeri nr.26- Koka furçe teli per motokorrese STIHL (ose ekuivalent) te montohet ne motokorrse te jete te paketuara. Standarte CE



Zeri nr.28 - Fryrse ajri me bateri 36 W= Te jete e kompletuar me karikuaes dhe bateri te githe aksesoret e nevojshem e gatshme per pune,cilesore sipas standarteve CE



Parametrat	Minimumi	Maximumi
Tensioni	36 V	36 V
Shpejtësia maksimale e ajrit	60 m/s (160 mph)	80 m/s (180 mph)
Volumi i ajrit	800 m ³ /h	850 m ³ /h
Fuqia e fryrjes	15 N	20 N
Pesha pa bateri	2.5 kg	3.5 kg
Niveli i zhurmës (presioni)	75 dB(A)	80 dB(A)
Niveli i zhurmës (fuqi akustike)	90 dB(A)	~95 dB(A)
Rezistenca ndaj ujit/pluhurit	E çertifikume	E çertifikume
Kontrolli i shpejtësisë	Po	Po
Jetegjatesia e baterise	Minimum 100 min	Maximumi 120 min

- **Shoqeruar me autorizim prodhuesi ose autorizim nga distriputor i autorizuar nga prodhuesi.**
- **Çertifikat cilesie te produktit.**
- **Disponueshmëri pjesësh këmbimi dhe servis**
- **Flete garancie minimumi 12 muaj nga distributori zyrtar dhe operatori.**

Zeri nr.31 Motokorrese me benzine

Parametrat	Minimumi	Maximumi
Cilindrata	$\geq 43 \text{ cm}^3$	$\leq 50 \text{ cm}^3$
Fuqia	$\geq 2.2 \text{ kW}$	$\leq 2.5 \text{ kW}$
Pesha	$\geq 8.0 \text{ kg}$	$\leq 9.5 \text{ kg}$
Diametri prerjes	$\geq 400 \text{ mm}$	$\leq 450 \text{ mm}$
Kapaciteti rezervuarit	$\geq 0.7 \text{ L}$	$\leq 0.8 \text{ L}$
Gjatësia pa vegël prerëse	$\geq 180 \text{ cm}$	$\leq 190 \text{ cm}$
Niveli zhurmës (sound pressure)	$\leq 102 \text{ dB(A)}$	$\leq 105 \text{ dB(A)}$
Niveli zhurmës (sound power)	$\leq 112 \text{ dB(A)}$	$\leq 115 \text{ dB(A)}$
Vibrimi majtas	$\leq 3.0 \text{ m/s}^2$	$\leq 3.5 \text{ m/s}^2$
Vibrimi djathtas	$\leq 3.0 \text{ m/s}^2$	$\leq 3.5 \text{ m/s}^2$



Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar . Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe.

Çertifikate cilesie te mallit

- **Disponueshmëri pjesësh këmbimi dhe servis**
- **Flete garancie minimumi 12 muaj nga distributori zyrtar dhe operatori.**

Zeri nr.32 - Fshese Fshesaresh Trapezoidale. Fshesë manuale e përshtatshme për pastrim të sipërfaqeve të forta si trotuare, oborre, magazina dhe ambiente industriale. E përbërë nga kokë me fije sintetike dhe bisht i gjatë ergonomik. Materiali i fijeve: Plastikë sintetike (PP/PET ose ekuivalent), Fortësia e fijeve: Mesatare – e fortë, Forma e kokës: Trapezoidale, Gjatësia e fijeve: $\geq 15 \text{ cm}$, Gjerësia e kokës së fshesës: $\geq 25 \text{ cm}$, Materiali i kokës: Plastikë rezistente ose ekuivalente, Materiali i bishtit: (alumin/druri) ose ekuivalent, Gjatësia e bishtit: $\geq 150 \text{ cm}$, Montimi: Me vidë ose sistem standard, Pesha totale: $\leq 1 \text{ kg}$,



Zeri nr.33 - Fshese Fshesaresh Trekëndore. Fshesë për pastrim manual të sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme, e përshtatshme për përdorim në rrugë, trotuare, oborre, ambiente industriale dhe magazina. E përbërë nga kokë me fije sintetike dhe bisht i gjatë ergonomik. Plastikë sintetike (PP/PET ose ekuivalent), Fortësia e fijeve: Mesatare – e fortë, Forma e kokës: Trekëndore për efikasitet në qoshe, Gjatësia e fijeve: ≥ 20 cm, Gjerësia e kokës së fshesës: ≥ 25 cm, Gjerësia e punës: 30–35 cm, Materiali i bishtit: (alumin/druri) ose ekuivalent, Gjatësia e bishtit: ≥ 150 cm, Montimi: Me vidë ose sistem standard, Pesha totale: 0.6-0.8 kg,



Shenim: Fotot e paraqitura janë referuese

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra ne zbatim te tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoritetikontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi...”Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomikë në këtë procedurë prokurimi është vendosur në funksion të natyrës specifike të aktivitetit që ushtron ndërmarrja jonë, e cila konsiston në ofrimin e shërbimeve të pastrimit. Për realizimin e këtij aktiviteti është e domosdoshme përdorimi i veglave të pastrimit që përmbushin standarde të caktuara cilësore dhe funksionale, duke garantuar efikasitet, qëndrueshmëri dhe përshtatshmëri me kushtet e punës. Në këtë kuadër, verifikimi i produkteve vetëm nëpërmjet katalogëve apo përshkrimeve teknike nuk është i mjaftueshëm, pasi këto të fundit paraqesin informacion të përgjithshëm dhe jo gjithmonë pasqyrojnë me saktësi karakteristikat reale të produktit që do të furnizohet. Për këtë arsye, kërkesa për mostra synon të mundësojë një vlerësim konkret dhe objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në veçanti, mostrat shërbejnë për të verifikuar elementë thelbësorë si cilësia e materialeve, rezistenca ndaj përdorimit të shpeshtë,

funksionaliteti dhe ergonomia e veglave të pastrimit, të cilat janë faktorë përcaktues në realizimin e shërbimit.

Sa më sipër, kërkesa për paraqitjen e mostrave nuk përbën një kriter kufizues për konkurrencën, por një mjet të nevojshëm dhe proporcional për garantimin e cilësisë së furnizimit dhe përmbushjen e nevojave specifike të autoritetit kontraktor, në përputhje me parimet e transparencës, barazisë në trajtim dhe efektivitetit në prokurimin publik

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE VEGLAVE PASTRIMI 2026

Nr	Emertimi i Artikullit dhe specifikimet Teknike
1	Fshesa melekuqe me bisht druri = Fshesa te jete me bisht e dendur me melekuqe dhe e qepur me spango mire.
2	Kaci metalike = Kacia te jete material metalik, Gjeresi 30 cm * Gjatesi 30 cm me bisht druri ose metalike 70 cm me bisht druri ose metalike 70 cm
3	Lopata transporti = Te jene metalike me a=26cm b=34cm,me bisht druri 122cm
4	Bisht fshesa =Te jete prej druri me diameter 3 cm gjatesia 170 cm
5	Lopate gerryerje =Te jete metalike me permasa gjersi 24 cm gjatesi 29 cm,me bisht druri 122 cm
6	Furçe pastrami druri me fije metalike = Te jete me fije teli,Gjatesi 50 cm*Gjersi 6.5 *Trashesi 2,fije metalike 4 cm,me bishtdruri i inkastruar me perforcime
7	Rrota karroca fshesaresh te pasme = Rrota te jete me diameter 25 cm,goma te mishta, te kene suport te fort metalik.
8	Rrota karroce fshesaresh te para = Rrota te jete me diameter 16 cm,goma te mishta, te kene suport te fort metalik, me rrotullim 360 grade.
9	Rrota per karroca llaçi = Te jene te mishta me disk metalik ,sipas standarteve
10	Rrota e kontinierit = Rrota te jete me diameter 200 mm, goma te mishta, te kene suport te fort metalik mbajtes me rrotullim 360 grade, disku i rrotes te jete metalik, rrotat duhet te jene me fren,Rrotat duhet te shoqerohen me bulonat(4 bulona+4 dado me gomin qe nuk lirohet +8 rrondele bllokimi)
11	Shpatull metalike me bisht te gjate profesionale= Te jete shpatull e gjitha metalike me teh te forte metalik me bisht te gjate 1,5m per grryerjen e dysHEMEVE
12	Fshesa plastike me bisht = Te jene sdandarte me gjersi 10 cm gjatesi 30 – 40 cm, me bisht druri, me gjatesi bishti 122 cm
13	Karroca betoni = Te jete me rrote te mishte standart,e fort metalike ,gjeresia 50cm, gjatesia 80 cm dhe thellesia 22 cm,trashesia e llamarines te jete δ2
14	Sfurqe = Te jete metalike me 5 dhembe ,me bisht druri 1-122 cm te lemuar
15	Kreher pune = Te jete metalik me gatesi 52 cm*gjersi 9 cm ,me bisht druri 122 cm.
16	Zorre zjarfikese e gomuar, kundra zjarrit Ø40- Ø50)= Shtresa e jashtme: Poliestër me densitet të lartë,Shtresa e brendshme: Gomë sintetike EPDM ose TPU,Presioni i punës 10-15 bar.
17	Bashkues 2" per zorre zjarrefikse Ø40- Ø50=Materiali: Alumin i farkëtuar i anodizuar,Rezistencë e lartë ndaj presionit, goditjeve dhe korrozionit ,Lidhje e sigurt dhe hermetike,te jete i pershtatshem per zerin


	16
18	Pipeta 2" per zorre zjarrfikse=Multifunksionale (jet / spray / mjegull), Alumin i anodizuar,Presioni i punës: 10 bar-15 bar,te jete i pershtatshem per zerin 17
19	Filispanje per stekat korrese me benzine=Te jete 3 -3,5 mm .
20	Kon sigurie rrugore =Te jete cilinrik Ø 5-7,me baze Ø 28-30,gjatesi 40cm,portokalli me shirita fosforeshent.
21	Motorrpompe uji per steke lavazhi 220 -250 Bar,minimumi 14/min□, rpm 3000-3600.Motorri te jete min 9-11 HP, te jete me karburant benzine,cilesore sipas standarteve CE
22	Steke lavazhi me presion 220-250 Bar = Te jete e kompletuar me doreze,steke,koke, pjeset te jene te çmontueshme dhe te pershtateshme me zerat nr 20,21,cilesore sipas standarteve CE
23	Zorre per steke lavazhi = Te jete zorre qe te mbaj presion 220-250 bar e kompletuar me kokat rapide e pershtateshme me zerin 22,21,24,29
24	Reduktor per kapje te shpejte nga pompa tek zorra e lavazhit=Te jene material inox,e pershtateshme me zerin nr 21,23,29
25	Koka per filispanje te motokorreseve STIHL (ose ekuivalent) te jene te paketuara standarte CE
26	Koka furçe teli per motokorrese STIHL (ose ekuivalent) te montohet ne motokorrse te jete te paketuara standarte CE
27	Rradac me bisht druri = Rradaci te jete me cope mikrofiber dhe me bisht druri
28	Fryrse ajri me bateri 36 W= Te jete e kompletuar me karikuaes dhe bateri,cilesore sipas standarteve CE
29	Motorrpompe uji per steke lavazhi 250 -300 Bar,minimumi 15/min □, rpm 3400-3600.Motorri te jete min 10-12 HP, te jete me karburant Naftë,cilesore sipas standarteve CE
30	Depozite uji 500 lt horizontale,materiali polietilen i klases ushqimore,trashesia 4-6 mm,anti UV,gjatesia 110-130 cm,gjersia 70-90 cm,lartesia 70-90 cm,pesha 12-20 kg,dalje uji me fileto 1/2-1.
31	Motokorese me benzine 2.2-2.5 kW ,te jete e perfshire koka per filispanje, disku,e kompletuar gati per pune.
32	Fshese Fshesaresh Trapezoidale= Fshesë manuale e përshtatshme për pastrim të sipërfaqeve të forta si trotuare, oborre, magazina dhe ambiente industriale. E përbërë nga kokë me fije sintetike dhe bisht i gjatë ergonomik.Materiali i fijeve: Plastikë sintetike (PP/PET ose ekuivalent),Fortësia e fijeve: Mesatare – e fortë, Forma e kokës: Trapezoidale, Gjatësia e fijeve: ≥ 15 cm,Gjerësia e kokës së fshesës: ≥ 25 cm,Materiali i kokës:Plastikë rezistente ose ekuivalente,Materiali i bishtit: (alumin/druri) ose ekuivalent,Gjatësia e bishtit: ≥ 150 cm,Montimi: Me vidë ose sistem standard, Pesha totale: ≤ 1 kg,
33	Fshese Fshesaresh Trekëndore =Fshesë për pastrim manual të sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme, e përshtatshme për përdorim në rrugë, trotuare, oborre, ambiente industriale dhe magazina. E përbërë nga kokë me fije sintetike dhe bisht i gjatë ergonomik.Plastikë sintetike (PP/PET ose ekuivalent),Fortësia e fijeve: Mesatare – e fortë, Forma e kokës: Trekëndore për efikasitet në qoshe, Gjatësia e fijeve: ≥ 20 cm, Gjerësia e kokës së fshesës: ≥ 25 cm, Gjerësia e punës: 30–35 cm, Materiali i bishtit: (alumin/druri) ose ekuivalent,Gjatësia e bishtit: ≥ 150 cm,Montimi: Me vidë ose sistem standard, Pesha totale: 0.6-0.8 kg,
34	Makineri pastrimi me furçe komandim dore me karburant 10-12 hp
35	Furce per makineri pastrimi me furçe komandim dore me karburant = cilindrike 30-40 cm,gjersia e punes 90-120 cm,materiali Polipropilen / najlon, e pershtatshme per zerin 34.

Specifikime me te detajuara per disa nga zerat;

Zeri nr.2 - Kacia metalike. Gjeresi 30 cm * Gjatesi 30 cm me bisht druri ose metalike 70 cm



Zeri nr.3 - Lopata transporti = Te jene metalike me a=26cm b=34cm,me bisht druri 122cm



Zeri nr.5 - Lopata grryerje me bisht druri. Gjersi 24cm *Gjatesi 29 cm + mbajtesja e bishtit 10 cm,me bisht druri 122 cm



Zeri nr.6 - Furçe pastrami me fije metalike me bisht druri.Gjatesi 50 cm*Gjersi 6.5
*Trashesi 2,fije metalike 4 cm, me bisht druri 122cm i inkastruar me perforcime



Zeri nr.11- Shpatull metalike me bisht druri.Gjersi 9.5 cm*Gjatesi 15.5 cm ,me bisht druri 122cm



Zeri nr.21 - Motorrpompe uji per steke lavazhi 220 -250 Bar,minimumi 14/min±, rpm 3000-3600.Motorri te jete min 9-11 HP, te jete me karburant benzine,cilesore sipas standarteve CE



Zeri nr.22 - Steke lavazhi me presion 220-250 Bar = Te jete e kompletuar me doreze,steke,koke, pjeset te jene te çmontueshme dhe te pershtateshme me zerat nr 23, cilesore sipas standarteve CE.



Zeri nr.23 -Zorre per steke lavazhi =Te jete zorre qe te mbaj presion 220-250 bar e kompletuar me kokat rapide e pershtateshme me zerin 22,,21,24,29. Cilesore sipas standarteve CE.



Zeri nr.24 - Reduktor per kapje te shpejte nga pompa tek zorra e lavazhit=Te jene material inox,e pershtateshme me zerin nr 21,23,29



Zeri nr.25- Koka per filispanje te motokorreseve STIHL (ose ekuivalent) te jene te paketuara standarte CE



Zeri nr.26- Koka furçe teli per motokorrese STIHL (ose ekuivalent) te montohet ne motokorrese te jete te paketuara. Standarte CE



Zeri nr.28 - Fryrse ajri me bateri 36 W= Te jene e kompletuar me karikuaes dhe bateri te githe aksesoret e nevojshem e gatshme per pune,cilesore sipas standarteve CE



Parametrat	Minimumi	Maximumi
Tensioni	36 V	36 V
Shpejtësia maksimale e ajrit	60 m/s (160 mph)	80 m/s (180 mph)
Volumi i ajrit	800 m ³ /h	850 m ³ /h
Fuqia e fryrjes	15 N	20 N
Pesha pa bateri	2.5 kg	3.5 kg
Niveli i zhurmës (presioni)	75 dB(A)	80 dB(A)
Niveli i zhurmës (fuqi akustike)	90 dB(A)	~95 dB(A)
Rezistenca ndaj ujit/pluhurit	E çertifikume	E çertifikume
Kontrolli i shpejtësisë	Po	Po
Jetegjatesia e baterise	Minimum 100 min	Maximumi 120 min

- Shoqeruar me autorizim prodhuesi ose autorizim nga distriputor i autorizuar nga prodhuesi.
- Çertifikat cilesie te produktit.
 - Disponueshmëri pjesësh këmbimi dhe servis
 - Flete garancie minimumi 12 muaj nga distributori zyrtar dhe operatori.

Zeri nr.29 - Motorrpompe uji per steke lavazhi 250 -300 Bar,minimumi 15/min ±, rpm 3400-3600.Motorri te jete min 10-12 HP, te jete me karburant Naftë, cilesore sipas standarteve CE



Zeri nr.31 Motokorrese me benzine

Parametrat	Minimumi	Maximumi
Cilindrata	≥ 43 cm ³	≤ 50 cm ³
Fuqia	≥ 2.2 kW	≤ 2.5 kW
Pesha	≥ 8.0 kg	≤ 9.5 kg
Diametri prerjes	≥ 400 mm	≤ 450 mm
Kapaciteti rezervuarit	≥ 0.7 L	≤ 0.8 L
Gjatësia pa vegël prerëse	≥ 180 cm	≤ 190 cm
Niveli zhurmës (sound pressure)	≤ 102 dB(A)	≤ 105 dB(A)
Niveli zhurmës (sound power)	≤ 112 dB(A)	≤ 115 dB(A)
Vibrimi majtas	≤ 3.0 m/s ²	≤ 3.5 m/s ²
Vibrimi djathtas	≤ 3.0 m/s ²	≤ 3.5 m/s ²



Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar . Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe. Çertifikate cilesie te mallit

- **Disponueshmëri pjesësh këmbimi dhe servis**
- **Flete garancie minimumi 12 muaj nga distributori zyrtar dhe operatori.**

Zeri nr.32 - Fshese Fshesaresh Trapezoidale. Fshesë manuale e përshtatshme për pastrim të sipërfaqeve të forta si trotuare, oborre, magazina dhe ambiente industriale. E përbërë nga kokë me fije sintetike dhe bisht i gjatë ergonomik. Materiali i fijeve: Plastikë sintetike (PP/PET ose ekuivalent), Fortësia e fijeve: Mesatare – e fortë, Forma e kokës: Trapezoidale, Gjatësia e fijeve: ≥ 15 cm, Gjerësia e kokës së fshesës: ≥ 25 cm, Materiali i kokës: Plastikë rezistente ose ekuivalente, Materiali i bishtit: (alumin/druri) ose ekuivalent, Gjatësia e bishtit: ≥ 150 cm, Montimi: Me vidë ose sistem standard, Pesha totale: ≤ 1 kg,



Zeri nr.33 - Fshese Fshesaresh Trekëndore. Fshesë për pastrim manual të sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme, e përshtatshme për përdorim në rrugë, trotuare, oborre, ambiente industriale dhe magazina. E përbërë nga kokë me fije sintetike dhe bisht i gjatë ergonomik. Plastikë sintetike (PP/PET ose ekuivalent), Fortësia e fijeve: Mesatare – e fortë, Forma e kokës: Trekëndore për efikasitet në qoshe, Gjatësia e fijeve: ≥ 20 cm, Gjerësia e kokës së fshesës: ≥ 25 cm, Gjerësia e punës: 30–35 cm, Materiali i bishtit: (alumin/druri) ose ekuivalent, Gjatësia e bishtit: ≥ 150 cm, Montimi: Me vidë ose sistem standard, Pesha totale: 0.6-0.8 kg,



Zeri nr.34 – Makineri pastrimi me furçe komandim dore me karburant.

Parametri	Minimum	Maximum
Fuqia	10 HP	12 HP
Ndezja = Elektrike + manuale		
Ftohja	Me ajër	
Kapacitet cilindrik	400cc	460 cc
Rezervuari	5 L	6.5 L
Konsumi	0.8 L/orë	1.2 L/orë
Transmisioni = Mekanik me ingranazhe		
Marshet =3 përpara / 3 mbrapa		
Diferencial = Me bllokim		
Tërheqja =2x2		
Shpejtësia	2 km/h	5 km/h
Furça kryesore	Cilindrike, 300 mm	Cilindrike, 400 mm
Gjerësia e punës	900 mm	1200 mm
Material furçash =Polipropilen / najlon	Polipropilen / najlon	
Kapacitet pune	3000 m ² /orë	5000 m ² /orë
Pesha	120 kg	180 kg
Përdorimi= Rrugë, trotuare, ambiente industriale		



Zeri nr.35 - Furçe për makineri pastrimi me furçe komandim dore me karburant, e përshtatshme për zeri nr. 34.

Parametri	Minimum	Maximum
Furça kryesore	Cilindrike, 30 cm	Cilindrike, 40 cm
Gjerësia e punës	90 cm	120 cm
Material furçash =Polipropilen / najlon	Polipropilen / najlon	
Përdorimi= Rrugë, trotuare, ambiente industriale		



Shenim:Fotot e paraqitura janë referuese

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Argumentim Teknik: Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato janë konceptuar duke përshkruar

minimumin e kërkesave të nevojshme teknike dhe funksionale që duhet të përmbushin mallrat, me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe performancës së tyre në përdorim.

Përcaktimi i këtyre kërkesave është bërë në mënyrë të argumentuar, duke u bazuar në nevojat konkrete të autoritetit kontraktor dhe në natyrën e veprimtarisë së tij në fushën e shërbimeve të pastrimit, ku përdorimi i veglave cilësore dhe funksionale është thelbësor për realizimin efektiv të shërbimit. Në këtë kuadër, kërkesat teknike janë orientuar drejt sigurimit të produkteve të përshtatshme për përdorim të përditshëm dhe intensiv, me materiale rezistente ndaj konsumimit, funksionalitet të lartë dhe ergonomi, duke garantuar njëkohësisht edhe sigurinë e punonjësve gjatë përdorimit. Çdo kërkesë e përcaktuar në specifikimet teknike lidhet drejtpërdrejt me funksionin që duhet të kryejë produkti dhe nuk tejkalon nivelin e nevojshëm për realizimin e qëllimit të kontratës, në respektim të parimit të proporcionalitetit. Njëkohësisht, specifikimet janë hartuar në mënyrë të tillë që të mos kufizojnë konkurrencën, pasi nuk përmbajnë referenca ndaj markave tregtare, prodhuesve të caktuar, origjinës apo proceseve specifike të prodhimit.

Në rastet kur janë përdorur standarde teknike, ato janë shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, duke garantuar mundësinë për pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe ofrimin e produkteve alternative që përmbushin të njëjtin nivel cilësie dhe performance. Në këtë mënyrë, specifikimet teknike shërbejnë si një instrument i domosdoshëm për garantimin e një procesi prokurimi efektiv dhe të drejtë, duke siguruar përmbushjen e nevojave të autoritetit kontraktor pa cenuar parimet bazë të konkurrencës së lirë.